

Data 03.09.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “NDËRTIMI I DHOMËS FRIGORIFERIKE
KUFOMAMBAJTËSE”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45210000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 99,891,705 (Nëntëdhjetë e nëntë milion e tetë qindë e nëntëdhjetë e një mijë e shtatë qindë e pesë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, specialisti i fushës së njësive të prokurimit të ngritur me urdhër **nr.7502 datë 03/09/2024** “Për ngritjen e Njësive të Prokurimit për procedurën e prokurimit publik me objekt: “Ndërtimi i dhomës frigoriferike kufomambajtëse” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, operatorët ekonomik duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtëme:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit i **kontratës objekt prokurimi**. (*Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori Ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor*).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrihen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte

kontabël ose shoqëri audituese: “c)shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej treguesve të mëposhtëm: i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e ta ardhurave nga veprimtaria ekonomike; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin e maturuar (sipas kësteve të parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar) në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së për vitin e maturuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së për vitin e maturuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të \prokurimit Publik”, i ndryshuar. Neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese”, si më sipër kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 76, pika 2, e LPP, i ndryshuar”.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendurae bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomik anëtarë të një bashkimi kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b, duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtëm:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9;
 - Kontratë sipërmarrje;
 - Situacion përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Certifikatë e marrjes në dorëzim të punimeve;
 - Faturat Tatimore

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

- b) Për kontratat e realizuara në sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontratë sipërmarrje;
 - Situacion përfundimtar;
 - Faturat tatimore.

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimiti së bashku me ndarjen e punëve midis operatorëve;

- Për kontrata e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
 - a) Kontratat bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor;

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 5, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë;

Mbështetur në rëndësinë e objektit të prokurimit, vlerën e fondit limit të vënë në dispozicion, tipologjinë e punimeve të ndërtimit etj.

2.3.1 /a Licenca profesionale të operatorit, për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar më Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategorite e mëposhtme:

Për punime të përgjithshme ndërtimi:

NP-1 A Punime gjurmimi në tokë.

NP-2 D Ndërtime civile dhe industriale.

NP-5 D Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

NP-7 A Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.

NP-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punime speciale ndërtimi:

NS-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.

NS-2 A Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre

NS-3 A Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).

NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

NS-8 C Ndërtime parafabrikat beton arme, Struktura metalike, struktura druri.

NS-12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

NS-13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.

NS-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

NS-18 A Punime topogjeodezike.

NS-20 A Shpime gjeologo inxhinieriek, puse e shpime për ujë.

Opërorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM -në, Nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane .

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve.

2.3.2 /b Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), kodi III.2.B “Grumbullimi, ruajtje dhe transportim të mbetjeve inerte dhe të ngurta”, ku të përfshihen dhe kodet 17 05 04 dhe 17 09 04 në përputhje me parashikimet e VKM-së Nr. 358, datë 26.05.2009 “për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera ligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Argumentim: Kërkesat e sipërcituara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77, pika 2 ku citohet se: “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë”, si dhe në zbatim të nenit 39, pika 6/a/b të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose”. Ndërsa përcaktimi i llojit të licencave nga ofertuesi, referuar natyrës së kontratës, bazohet në ligjin 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në VKM-në nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

2.3.3 /a Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë ose licencë përkatëse si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimum për periudhën 6 (gjashtë) mujori i fundit nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 Inxhinier ndërtimi;
- 1 inxhinier ndërtimi (strukturist);
- 1 inxhinier mekanik;
- 1 inxhinier gjeolog;
- 1 inxhinier hidroteknik;
- 1 akritekt;
- 1 inxhinier mjedisi;
- 1 inxhinier gjeoteknik;

- 1 inxhinier topograf/gjeodet/markshajder;
- 1 inxhinier elektrik/informatik/telekomunikacion.

Vërtetuar me dokumentacion si më poshtë:

- *Kontratë pune, diplomë, librezë pune dhe CV*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të \prokurimit Publik”, i ndryshuar.Neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese ”, si më sipër kërkuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe specifikimeve teknike. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, kapaciteti teknik në DST.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Në preventivin e Punimeve ka zëra pune ku del e qartë domosdoshmëria dhe nevoja për prezencën e inxhinierëve të kërkuar.

Inxhinieret e kërkuar janë në përputhje me licencat e kerkuara.

Stafi i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.
Konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi- Në preventiv parashikohen punime gjurmimi, punime ndërtimi;
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili strukturor- Në preventiv parashikohen punime gjurmimi, punime ndërtimi;
- 1 (një) Inxhinier Mekanik- Në preventiv parashikohen punime për të cilat janë të nevojshme punime të termodinamikës, kondicionimi etj.
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog – Në preventiv parashikohen punime gjurmimi, dhe dhe si rrjedhojë merret me studimin e shtresave gjeologjike të tokës, si edhe shpimet për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik- Në preventiv parashikohen punime për sisteme hidrosanitare
- 1 (një) Arkitekt – në preventive parashikohen punime arkitekturore
- 1 (një) Inxhinier Mjedesi- për ndikimin e punimeve ndërtimore në mjedis.
- 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik- Në preventiv parashikohen punime me përbërjen e shtresave për strukturat mbajtëse të dheut etj.
- 1 (një) Inxhinier topograf/gjeodet/markshnajder- Në preventiv parashikohen punime gjeodezike
- 1 (një) Inxhinier Elektrik/infomatik/telekomunikacion- Në preventiv parashikohen punime për rikonstrukcion të rrjetit elektrik të ndërtesës etj.

2.3.2 /b Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucionet (shtetërore apo private), të licensuara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr.15/2007 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimum për periudhën 3(tre) mujori i fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- Teknik ndërtimi : 1 punonjës
- Teknik topograf: 1 punonjës
- Elektricitist : 2 punonjës
- Murator : 3 punonjës
- Suvatues: 1 punonjës
- Specialist për systemin ngrohje ftohje: 2 punonjës
- Pllakashtrues : 1 punonjës
- Hekurkthyes: 3 punonjës
- Karpentier : 2 punonjës
- Saldator 2 punonjës
- Mekanik : 1 punonjës
- Hidraulik: 1 punonjës

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të \prokurimit Publik”, i ndryshuar.Neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese”, si më sipër kërkuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar, dhe Udhëzimit nr.2, datë 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve të ndërtimit”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar punonjësit e mësipërm, me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”, të ndryshuar.

Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për përfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (*Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018*), të ndryshuar, *Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport)*. Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Stafi i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve. Konkretisht:

- 1 (një) punonjës teknik ndertimi- Për të kontrolluar punën ndërtimore dhe për të dhënë udhëzime të ndryshme për punimet
- 1 (një) punonjës teknik topograf- për të piketuar konturet, kuotat dhe akset e objektit
- 2 (dy) punonjes elektrikist - për punimet e instalimeve elektrike të preventivit

- 3 (tre) punonjës murator- punime mutarure, punime betoni
- 1 (një) punonjës suvatues- punime tavan dhe suvatime
- 2 (dy) punonjës specialist për systemin ngrohje ftohje- për punimet sistemit ngrohje ftohje
- 1 (një) punonjës pllakashtrues – për shtrimin e pllakave sipas projektit
- 3(tre) punonjës hekurkthyes – për përpunimin e hekurit gjatë punimeve
- 2 (dy) punonjës karpnier- për punime të armaturave
- 2 (dy) punonjës saldator- për punimet e saldimit
- 1(një) punonjës mekanik- për riparimin të ndryshme gjatë proceve të punës.
- 1 (një) punonjës hidraulik- për punimet hidraulike sipas projektit

2.3.3/c Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve, objekt kontrate duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues Teknik në licencën e shoqërisë), të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, si dhe të deklaruar në listëpagesë të paktën 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 Inxhinier ndërtimi- profili gjeoteknik
- 1 inxhinier hidroteknik
- 1 Inxhinier ndërtimi

Vërtetuar me dokumentacionin si më poshtë:

Kontratë pune, diplomë, librezë pune dhe Cv.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të \prokurimit Publik”, i ndryshuar.Neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese ”, si më sipër kërkuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, (pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të dy kritereve të sipërcituara lidhur me stafin inxhinierik, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe specifikimeve teknike. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Gjithashtu nisur edhe nga kushtet ku ndodhet objekti që do të ndërtohet gjykojmë që është shumë i nevojshëm stafi mbështetës:

1 Inxhinier ndërtimi- profili gjeoteknik pasi objekti është pranë objekteve egzistuese, do të punohet nëntoke me gërmime me thellësi deri 12 ml

1 inxhinier hidroteknik -në preventive janë parashikuar punime për këtë kategori

1 Inxhinier ndërtimi-Në preventiv parashikohen punime gërmimi, punime ndërtimi

2.3.3 /d Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punime në objekt. Drejtuesi Teknik i punimeve i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve e punimeve të ndërtimit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.3 /e) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë për Mbrojtje nga Zjarri të lëshuar nga QKL, kodi 1.2.A dhe të ketë të punësuar në stafin e tij të paktën 1 (një) ekspert zjarrëfikës i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 6 muajt e fundit. Për eksperetën zjarrëfikës të paraqitet kontrata e punës dhe certifikatë/ dëshmi kualifikimi për ushtrimin e profesionit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.Neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese”, si më sipër kërkuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të nenit 39, pika 6/c), të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, të VKM-së nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit,

klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar, dhe të Udhëzimit nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe specifikimeve teknike. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë , kapaciteti teknik në DST.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit ekspert të paisur me licensën përkatëse të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Kërkesa për punonjës të kualifikuar dhe të specializuar është bërë referuar VKM nr.627, datë 11.06.2009 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, si dhe në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", si dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, si dhe në pikën 4, të nenit 49, të Ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin”, kështu;

Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili duhet te jetë i 1(një) ekspert zjarrfikës të shoqëruar me certifikatë/dëshmi kualifikimi për ushtrimin e profesionit lëshuar nga PMNZH, shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e tij, i cili nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangi apo parandaloje çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtyre kriterëve shërben si një garanci që OE do të reazlizojë punimet në kantierin e hapur të punës.

Disponimi i këtij punonjësi si një staf i përhershëm i kompanisë garanton qëndrueshmëri dhe siguri se eksperti është një punonjës i kompanisë dhe do të garantohet prezenca e tij e përhershme në kantier gjë e cila nuk garantohet në rastin e ekspertëve të jashtëm kontraktohen me kohë të pjeshme në kantier.

Siguria e punës në kantier dikton që eksperti zjarrfikës ashtu si edhe në rastin e ekspertit "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" të jetë i punësuar më kohë të plotë dhe që operatori/ et ekonomik të jenë përgjegjës për garantimin e këtij punonjësi.

Periodha e kërkuar për disponimin e punonjësve të kërkuar vecanërisht ata me kualifikime profesionale, i referohet përcaktimeve ligjore të sipërpërmendura dhe faktit që Operatori/ët pjesëmarrës duhet të garantojnë dhe dëshmojnë qëndrueshmëri dhe besueshmëri për disponimin e punonjësve sidomos punonjësit e trajnuar dhe që kanë një eksperiencë dhe dëshmojnë se punojnë në profilet dhe profesionet përkatëse për një periudhë që e justifikon qëndrueshmërinë dhe cilësinë e punës së kërkuar. Për periudhën prej 6 muajsh parashikohet vetdeklarimi dhe në rastet e paraqitjes së dokumentacionit, Listëpagesat janë të aksesueshme në cdo kohë nga vet operatorët dhe Autoritetet nëpërmjet portalit E-Albania.

2.3.3 /f) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë për Ndikimin në Mjedis të lëshuar nga QKL, Kodi III.2.A (1+2) si dhe të ketë të punësuar në stafin e tij të paktën 1 (një) ekspert mjedisi I cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 6 muajt e fundit. Për ekspertin e mjedisit të paraqitet kontrata e punës dhe certifikatë e Ekspert i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të \prokurimit Publik”, i ndryshuar.Neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese”, si më sipër kërkuar.

Argumentimi: Operatori/ët ekonomik/ë, gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të nenit 39, pika 6/c), të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, të VKM-së nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin

e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar, dhe të Udhëzimit nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Periudha e kërkuar për disponimin e punonjësve të kërkuar vecanërisht ata me kualifikime profesionale, i referohet përcaktimeve ligjore të sipërpërmendura dhe faktit që Operatori/ët pjesëmarrës duhet të garantojnë dhe dëshmojnë qëndrueshmëri dhe besueshmëri për disponimin e punonjësve sidomos punonjësit e trajnuar dhe që kanë një eksperiencë dhe dëshmojnë se punonjë në profilet dhe profesionet përkatëse për një periudhë që e justifikon qëndrueshmërinë dhe cilësinë e punës së kërkuar. Për periudhën prej 6 mujore parashikohet vetdeklarimi dhe në rastet e paraqitjes së dokumentacionit, Listëpagesat janë të aksesueshme në cdo kohë nga vet operatorët dhe Autoritetet nëpërmjet portalit E-Albania.

Disponimi i këtij punonjësi si një staf i përhershëm i kompanisë garanton qëndrueshmëri dhe siguri se eksperti është një punonjës i kompanisë dhe do të garantohet prezenca e tij e përhershme në kantier gjë e cila nuk garantohet në rastin e ekspertëve të jashtëm kontraktohen me kohë të pjeshme në kantier.

Siguria e punës në kantier dikton që eksperti mjedisor ashtu si edhe në rastin e ekspertit "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" të jetë i punësuar më kohë të plotë dhe që operatori/ et ekonomik të jenë përgjegjës për garantimin e këtij punonjësi.

Kjo garanton cilësinë dhe sigurinë e respektimit të standarteve mjedisore në ambientet e kantierit dhe zonën përreth., kjo është e lidhur edhe me faktin që kerkohet disponimi i një eksperti në një kompani që është e Licencuar me licencat përkatëse për Ndikimin ne Mjedis dhe disponimi si të punësuar të përhershëm të kompanisë i ekspertëve të kualifikuar është një kërkesë e arsyeshme dhe e mbështetur që siguron qëndrueshmëninë, seriozitetin dhe sigurinë për ofrimin e një shërbimi dhe realizimin e punimeve sipas kërkesave dhe standarteve të kerkuara.

2.3.3/g) Operatori ekonomik me qëllim respektimin e standardeve të sigurisë konform ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, duhet të dëshmojë se kanë pjesë të stafit të shoqërisë, personel të trajnuar/certifikuar për punimet në lartësi, jo më pak se 2 (dy) punonjës të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 3 muajt e fundit.

Vërtetuar me dokumentacionin si më poshtë:

- *Kontratë pune*
- *Certifikata/ diploma përkatëse*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të \prokurimit Publik”, i ndryshuar.Neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese ”, si më sipër kërkuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar, dhe Udhëzimit nr.2, datë 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve të ndërtimit”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.3 h) Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar në stafin e tij min 1 (një) punonjës që disponon certifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” , i/të cili/ët duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 3 muajt e fundit.

2.3.4

Vërtetuar me dokumentacionin si më poshtë:

- *Kontratë pune*
- *Certifikata/ diploma përkatëse*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të \prokurimit Publik”, i ndryshuar.Neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese ”, si më sipër kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa për punonjës të kualifikuar dhe të specializuar është bërë referuar VKM nr.627, datë 11.06.2009 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”, si dhe në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", si dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Janë kërkuar specialistë ndihmës për të gjitha proceset e punës, në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre, specialistë këto të çertifikuar sipas legjislacionit të formimit profesional. Po kështu, meqënëse ky objekt është ndërtim dhe ndodhet në një pjesë shumë të rëndësishme të kryeqytetit, të mbipopulluar dhe me shumë levizje është kërkuar që të gjithë specialistët të kenë një eksperience të konsoliduar në profesionin e tyre, gjë që do të krijojë mundësinë për punime sa më cilësore, pa vënë në rrezik objekteve fqinje, apo të të sëmureve pranë spitaleve që janë përreth objektit që do të ndërtohet.

2.3.5 2.3.3 i) Operatori ekonomik për të siguruar shërbimin mjekësor në shoqëri duhet të ketë të punësuar një mjek të përgjithshëm ose të ketë të kontraktuar nga jashtë këtë shërbim. Në rastin kur mjeku është i punësuar pranë shoqërisë duhet paraqitur kontrata e punës, licencë për ushtrimin individual të profesionit dhe diploma, dhe të të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën 3 muajt e fundit. Në rastin kur ky shërbim është i kontraktuar me subjekte të specializuara për këtë qëllim, të paraqitet kontrata e shërbimit dhe licenca përkatëse.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të \prokurimit Publik”, i ndryshuar.Neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese ”, si më sipër kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa për një Mjek mbështetet në Vendimin Nr.632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” si dhe në Vendimin nr.692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, ku përcaktohet se: “.....marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.”

1.3.3. /j) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimum për periudhën 3 (tre) mujori i fundit të deklaruar nga ana e hapjes së ofertave minimum 4 (katër) shoferë dhe 2 manovrator.

Vërtetuar me dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë pune
- Leje drejtimi kategoria jo më e ulët se “C”
- Certifikatë Aftëisimi Profesional

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.Neni 26 “Formulari Përbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese ”, si më sipër kërkuar.

Në rastet kur operatori i disponon mjetet në bazë të një kontrate qiraje, punonjësit e mësipërm mund të disponohen me të njëjtat kushte nga Subjekti qiradhënës. Në këtë rast operatori duhet të paraqesë përvec dokumentacionit të marrjes me qira të mjeteve edhe të gjithë dokumentacionin e kërkuar për punonjësit,

Subjekti qeradhënës duhet të ketë të punësuar si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimum për periudhën 3 (tre) mujori i fundit të deklaruar nga ana e hapjes së ofertave shoferë dhe/ose manovratorët në perputhje me numrin e mjeteve.

Vërtetuar me dokumentacionin si më poshtë:

- Listapagesat
- Kontratë pune
- Leje drejtimi kategoria jo më e ulët se “C”
- Certifikatë Aftëisimi Profesional
- Si edhe nje deklarate/ angazhim nga Subjekti qiradhënës per vendosjen ne dispozicion te punonjesve te sipercituar

Argumentimi: Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar punonjësit e mesipërm, me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”, të ndryshuar.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c) dhe 6/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Vendosja e ketyre kritereve për fuqine punëtore është bërë në perputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj

kontrate. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Për manovratorët, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar Manovratorë me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

Autoriteti mban në konsideratë që për rastin kur mjetet e kërkuara disponohen me kontratë qiraje këta punonjës mund të jenë të kontraktuar, në përputhje me numrin e mjeteve që do të disponohen me qira.

Për këtë pikë Autoriteti Kontraktor mban parasysh dhe do të pasqyrojë shtesën përkatëse në Dokumentat Standarte të Tendërit, nëpërmjet nje shtojce duke specifikuar si me poshte: Në rastet kur operatori i disponon mjetet në bazë të një kontrate qiraje, punonjësit e mësipërm mund të disponohen me të njëjtat kushte nga Subjekti qiradhënës. Në këtë rast operatori duhet të paraqesë përveç dokumentacionit të marrjes me qira të mjeteve edhe të gjithë dokumentacionin e kërkuar për punonjësit,

Subjekti qeradhënës duhet të ketë të punësuar si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimum për periudhën 3 (tre) mujori i fundit të deklaruar nga ana e hapjes së ofertave shoferë dhe/ose manovratorët në përputhje me numrin e mjeteve.

Vërtetuar me dokumentacionin si më poshtë:

Listapagesat

- Kontratë pune
- Leje drejtimi kategoria jo më e ulët se “C”
- Certifikatë Aftëisimi Profesional
- Si edhe një deklaratë/ angazhim nga Subjekti qiradhënës për vendosjen ne dispozicion të punonjësve të sipërcituar

2.3.3 /k) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar një numër minimal prej 80 të punësuarish për periudhën 6 (gjashtë) mujori i fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve është bërë një analizë bazuar tek kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje, (6 muaj), tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 80 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM-në nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). (Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore. Ky kriter është gjithashtu i bazuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,

Vendosja e kërkesave të mësipërme është bërë për të vërtetuar kapacitetin teknik të OE, i cili duhet të disponojnë një staf të mjaftueshëm jo më pak se 80 punonjës, për të përmbushur me sukses dhe në kohë kontratën, si dhe mbështetur në preventivin, volumet e punës, afatin, specifikimeve, zërat e punës, të cilët duhet të angazhohen në objekt, përjashtimisht punonjësve të tjerë nëse OE mund të kenë kontrata të tjera në vazhdim. OE duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Emri mjetit	Njësi	Sasi	Statusi	Përshtatmëria me preventivin
1	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 10 deri 15 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qera	Punime gërmimi dhe prishje
2	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 15 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qera	Punime gërmimi dhe prishje
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës 3.5 ton	Copë	3	Në pronësi ose me qera	Punime gërmimi dhe prishje
4	Eskavator me zinxhir me kapacitet 25 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qera	Punime gërmimi dhe prishje
5	Eskavator me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Punime gërmimi dhe prishje
6	Minieskavator 3-5 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Punime gërmimi dhe prishje
7	Minifadrome tip Bob Cat, ekuivalente	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Punime gërmimi dhe prishje
8	Dumper me volume 1500 L-2000 L	Copë	2	Në pronësi ose me qera	Punime gërmimi dhe prishje
9	Rrul ne gome cilinder	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Punime shtresash
10	Rrul për nivelim shtresash	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Punime shtresash
11	Autopompe Betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Punime me beton
12	Autobetoniere	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Punime betony
13	Kompresor ajri	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Punime të ndryshme

14	Gjenerator min 10 kë	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Për vënien në punë të pajisjeve në pamundësi për të marrë rrymë elektrike.
15	Ndricules kulle me gjenerator	Copë	2	Në pronësi ose me qera	Për ndricim në pamundësi për të marrë rrymë elektrike
16	Saldatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Për punimë saldimit
17	Motosaldatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Për punimë saldimit
18	Pompe uji	Copë	2	Në pronësi ose me qera	Për të bërë llac dhe lagje
19	Betoforma	M ²	1000	Në pronësi ose me qera	Për punime betoni
20	Tokmak Elektrik	Copë	2	Në pronësi ose me qera	Për punime shtresash
21	Tranxhe	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Për përpunimin e hekurit
22	Elektrobang	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Për përpunimin e hekurit
23	Matrapik	Copë	2	Në pronësi ose me qera	Prishje, thyerje
24	Kompaktor	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Për ngjeshje
25	Depozita uji 5000 l	Copë	2	Në pronësi ose me qera	Për të bërë llac
26	Vinç karel 10 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Për transport hekur, materialesh te ndryshme
27	Skela	M ²	400	Në pronësi ose me qera	Mbrojtëse sigurie
28	Betoniere	Copë	2	Në pronësi ose me qera	Për prodhim betoni
29	Vibrator Betoni	Copë	2	Në pronësi ose me qera	Betonime
30	Nivelues Helikopter	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Nivelimin e shtresave

31	Semafor rruge	Copë	2	Në pronësi ose me qera	Për drejtimine mjeteve në kantier
32	Tabela Paralajmeruese	Copë	20	Në pronësi ose me qera	Për sigurinë në punë të punëtorëve
33	Fikese zjarri	Copë	2	Në pronësi ose me qera	Për sigurinë në punë të punëtorëve
34	Komplet i ndihmës së shpëjtë	Copë	2	Në pronësi ose me qera	Për sigurinë në punë të punëtorëve
35	Autobot uji	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Për furnizimin me ujë në kantier
36	Autovinc	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Transport hekur, materiale të ndryshme
37	Sond për pilota	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Për procesin e punimit të pilotave
38	Fadromë me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Punime gjurmimi dhe prishje
37	Kokore	Copë	30	Në pronësi ose me qera	Për sigurinë në punë të punëtorëve
38	Zyrë	Copë	1	Në pronësi ose me qera	Për personelin teknik
39	Jelekë	Copë	30	Në pronësi ose me qera	Për sigurinë në punë të punëtorëve

- (a) Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: - certifikatë pronësie; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit Teknik; -siguracionin; - leja e transportit e lëshuar nga njësia vendore dhe fotot përkatëse;
- (b) Ndërsa përmjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- (c) Për mjete që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve;
- (d) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- (e) Për mjetet apo pajisjet e tjera nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore e blerjes ose document zhdoganimi të mjetit dhe fotot e tyre.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të \prokurimit Publik”, i ndryshuar.Neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese”, si më sipër kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili është publikuar së bashku me Dokumentat e Tenderit).

2.3.5 *Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se zhvillon aktivitetin në fushën e objektit prokurimit në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit të sigurisë në punë dhe mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat, si më poshtë:*

- a) *Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe ose ekuivalente.*
- b) *Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe ose ekuivalente.*
- c) *Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ose ISO 45001:2018 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe ose ekuivalente.*

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcak tuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin

në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësuar performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi. Në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”. Për sa më lart, gjykohet se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zërat elektrik të Preventivit. AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 10 gërma “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve në lidhje me përcaktimin: Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe legjislacionin në fuqi për ndërtimet, duke u bazuar në gjendjen ekzistuese të objektit dhe projekteve përkatëse të zbatimit (projektin e punimeve ndërtimore, projektin e punimeve elektrike dhe projektin e punimeve hidrosanitare) me qëllim përshkrimin e cilësisë të të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesave të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

Fondi limit për këtë procedurë është përlllogaritur në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 629 date 15.07.2015 “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin

dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, duke u bazuar në volumet e punimeve të parashikuara në projektin dhe preventivin bashkëngjitur.